

Lista e Organizatave Joqeveritare ndaj të cilave Departamenti për OJQ/MAP, me datë 26 tetor 2015, në bazë të kërkesës së Organit kompetent të sigurisë ka marr vendim për pezullimin e veprimtarisë së tyre:

- 1. Asociacioni për Kulturë, Edukim dhe Arsim(AKEA);**
- 2. Al-wakaf al Islami;**
- 3. Kalliri i Mirësisë;**
- 4. Siqeriteti;**
- 5. Çelsi;**
- 6. Pema e Bëmirsisë;**
- 7. Kosova Aid development(KAD);**
- 8. Rinia Istogase;**
- 9. Hektari-He;**
- 10. Njëshmëria;**
- 11. Parimi;**
- 12. Gurma;**
- 13. Mesxhidi Studentor**

2.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Administratës Publike – Ministarstvo Javne Administracije
Ministry of Public Administration

Ref. 06/342/2015

Departamenti për Organizata Jo-Qeveritare Ministria e Administratës Publike, në pajtim me Nenin 9 paragrafi 9 lidhur me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, si dhe lidhur me nenin 18 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ QRK-NR. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksonimin e Organizatave Joqeveritare, duke vendosur sipas kërkesës së Organit Kompetent të Sigurisë, Departamenti për OJQ më datë 26 tetor 2015, merr këtë:

V E N D I M

1. **Pezullohet veprimtaria e Organizatë Jo-Qeveritare,, GJURMA” me numër regjistrimi 5100152-4 e regjistruar me datë 25/02/2000.**
2. **Vendimi mbi Pezullimin e Veprimtarisë së kësaj organizate vlen deri në vendimin tjetër.**

Arsyetim

Bazuar në kërkesën e Organit Kompetent të Sigurisë datë 23.10.2015, për Pezullimin e Veprimtarisë OJQ-së „ **GJURMA** “ me numër regjistrimi **5100152-4** e regjistruar me datë **25/02/2000**, Departamenti për OJQ/MAP vendosi si më lartë.

Kërkesa për Pezullimin e veprimtarisë së OJQ-së „ **GJURMA**” me numër regjistrimi **5100152-4** regjistruar me datë **25/02/2000**, është bazuar në informacionet e institucioneve kompetente të sigurojë se ekziston dyshimi i bazuar që veprimtaria e OJQ-së „ **GJURMA**”, bie ndesh me interesat e sigurojë dhe nuk përkon me rendin juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës dhe me të drejtat ndërkombëtare, rrjedhimisht ka bërë shkelje edhe të normave juridike të statutit në bazë të cilit është regjistruar.

Departamenti për OJQ Ministria e Administratës Publike, pas shqyrtimit të kërkesës të parashtruar Organit Kompetent të Sigurisë, për Pezullimin e Veprimtarisë së Organizatës në fjalë, duke u bazuar në nenin 16 Paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, si lidhur me nenin 18 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ QRK-NR. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksonimin e Organizatave Jo-qeveritare, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

